

REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE NËN
HIJEN E HARTËS SË RE GJYQËSORE

Rina SALIAJ

Nosiana BURNAZI



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PUBLIKUES

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3. (Dora D'Istria)
Tel: +355 44 104 247
E-mail: info@em-al.org
Web: www.em-al.org

AUTORË

Rina Saliaj, Nosiana Burnazi

VITI I PUBLIKIMIT

qershor 2024

Rina (Pero) SALIAJ është avokate dhe një juriste me përvojë të gjërë në fushën e ligjit dhe financave. Ajo ka një eksperiencë të gjatë si drejtore e A.R. S Legal & Financial Services, si dhe ka kontribuar dhe është përfshirë në projekte të ndryshme të shoqërisë civile dhe të biznesit në fusha si pronësia intelektuale, të drejtat e punës, dhe procedurat gjyqësore.

Nosiana BURNAZI ka kryer studimet pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Ajo është e angazhuar pranë organizatës "Vish këpucët e mia" si koordinatore projektesh. Gjithashtu, Nosiana punon si asistente ligjore pranë zyrës A.R.S Legal & Financial Services.

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Hyrje	03
Nevoja për një Hartë të Re Gjyqësore	04
Ndihma Juridike Dytësore dhe Përfituesit	05
Problematikat e përfitimit të Ndhmës Juridike Dytësore	07
Përfundime dhe Rekomandime	09
REFERENCA	10

Funksionimi i hartës së re gjyqësore paraqet një prej situatave më të debatuar me të cilën është përballur sistemi gjyqësor përgjatë dy viteve të fundit. Ri-organizimi i gjykatave, e më në veçanti i kompetencave të tyre tokësore, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë tek parimet themelore mbi të cilat mbështetet pushteti gjyqësor. Më konkretisht ky punim trajton parimin e aksesit në drejtësi të kategorive të veçanta të cilat në bazë të ligjit nr. 111//2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përfitojnë ndihmën juridike dytësore për të përfituar këshillim, mbrojtje e përfaqësim përpara organeve gjyqësore. Përmes analizimit të ndryshimeve konkrete mbi numrin dhe shtrirjen e gjykatave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të studimit të ecurisë së ndihmës juridike dytësore përgjatë vitit të kaluar, do të zbulohet situata aktuale e kuadrit ligjor për të nxitur më tej diskutimet mbi sfidat që zbatimi i këtyre ndryshimeve të reja do të sjellë për kategoritë e veçanta. Pas analizës teorike, analiza ndalet tek problematikat praktike që ekzistojnë dhe ndikimin që harta e re gjyqësore ka në thellimin e tyre. Së fundi, pas analizës dhe studimit të plotë të kornizës ligjore, do të japim rekomandime mbi ndryshimet e nevojshme ligjore që duhen ndërmarrë, në mënyrë që aksesit në sistemin e drejtësisë të jetë i barabartë për të gjithë individët, ashtu si edhe parashikohet nga akti më i lartë i shtetit, Kushtetuta.

Nevoja për një Hartë të re Gjyqësore

Aksesi në drejtësi përbën një prej parimeve bazë mbi të cilat funksionon sistemi gjyqësor. Ky parim garantohet nga akti më i lartë juridik i shtetit, Kushtetuta, si dhe gjen mbrojtjen ligjore në ligje të tjera, qofshin këto materiale apo procedurale. Çdo individ i njihet mundësia për të kërkuar në rrugë ligjore mbrojtjen e të drejtave të garantuara në rast se pretendon shkeljen e tyre. Përmes kësaj mundësie të dhënë nga ligji, individët duhet të gjykohen nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e caktuar me ligj, bazuar në një proces të rregullt ligjor, si dhe brenda një afati të arsyeshëm. Zbatimi me korrektësi i këtij parimi prej organeve apo institucioneve përgjegjëse, i hap rrugë fillimit të proceseve gjyqësore, si dhe zbatimit të mëtejshëm të të gjitha garancive e parimeve ligjore, të cilat përbëjnë bazën e rendit juridik.

Në mbështetje të ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) vendosi ngritjen e grupit të punës, me qëllim riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave. Nevoja për këtë riorganizim lidhet drejtpërdrejt me pasojat e zbatimit të Reformës në Drejtësi, e cila solli ndryshime thelbësore në sistemin gjyqësor. Mungesat e krijuara për shkak të procesit të vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, numri shumë i lartë i çështjeve të mbetura stok në gjykata, afati shumë i gjatë brenda të cilit një çështje gjykohet në mënyrë përfundimtare, janë vetëm disa prej problematikave me të cilat është përballur sistemi gjyqësor në Shqipëri ndër vite.

Bazuar në Raport Vlerësimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor[1], u propozua ulja e numrit të gjykatave si më poshtë:

- Nga 22 Gjykata të Shkallës së Parë (me juridiksion të përgjithshëm) të ngelen 13;
- Nga 6 Gjykata Administrative të Shkallës së Parë të ngelen 2;
- Nga 6 Gjykata Apeli në të gjithë Shqipërinë të ngelet vetëm një në Tiranë.

Ky propozim, tashmë ka hyrë plotësisht në fuqi, ku më datë 1 korrik 2023 u krye dhe riorganizimi i fundit, konkretisht i Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë, por megjithatë Këshilli i Lartë Gjyqësor u përball me kundërshtime të shumta mbi zbatimin e kësaj harte të re gjyqësore. Organizata të shoqërisë civile, institucione të pavarura (ku më kryesori Avokati i Popullit), si dhe organizma ndërkombëtarë dhanë rekomandime të shumta mbi gjetjen e zgjidhjeve të tjera alternative, për të shmangur zbatimin e një organizimi që tkurri pjesën më të madhe të gjykatave të vendit.

Neni 14 i Ligjit nr. 98/2016 parashikon se kompetencat tokësore të gjykatave caktohen duke synuar përmbushjen e objektivave të garantimit të aksesit në drejtësi, nevojën për uljen e kostove dhe garantimin e përdorimit të burimeve publike, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara. Si do të ndikojë ky riorganizim territorial i gjykatave, në mundësinë që do të kenë qytetarët për të aksesuar gjykatat fizikisht dhe proceduralisht? Në mënyrë më konkrete, si do të preket e drejta e aksesit në gjykatë e kategorive të veçanta të cilat në bazë të ligjit nr. 111//2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përfitojnë ndihmën juridike dytësore për të përfituar këshillim, mbrojtje e përfaqësim përpara organeve gjyqësore?

Ndihma Juridike Dytësore dhe Përfituesit

“Ndihmë juridike dytësore” është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislationit procedural penal. Ligji nr. 111//2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ka parashikuar në mënyrë shteruese kategoritë e subjekteve që mund të jenë përfitues të ndihmës juridike. Në të përfshihen:

- shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj, personat pa shtetësi, azilkërkuessit, personat që gëzojnë statusin e refugjatit nëse provojnë se kanë të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për përfaqësim apo mbrojtje në çështjet gjyqësore;
- kategoritë e veçanta, të parashikuara në nenin 11, të cilat nuk kanë nevojë të provojnë të ardhurat e tyre.[2]

Lidhur me kategorinë e parë, të ardhurat e një personi, janë të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara me numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50% e pagës minimale mujore. Sipas vendimit Nr. 113, datë 1.3.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”[3], duke filluar nga data 1 prill 2023, paga bazë minimale mujore, në shkallë vendi është 40 000 Lek.

Nëse të ardhurat e një individi në muaj janë 20 000 Lek apo më tepër, ai nuk mund të përfitojë nga ndihma juridike dytësore. Mungojnë analiza të mirëfillta nëse një individ me të ardhura mujore 20 000 Lek mund të paguajë kostot e një avokati, të transportit për në gjykatë për avokatin dhe për të, si dhe për të gjitha kostot gjyqësore dhe administrative të procesit. Këto kosto, padiskutim që janë rritur tashmë prej organizimit të ri territorial të gjykatave, por nuk duhet harruar se sistemi gjyqësor duhet të jetë i hapur dhe i aksesueshëm nga të gjithë qytetarët dhe kursesit nuk duhet të kufizohet prej gjendjes ekonomike.

Në kategorinë e fundit të sipërpërmendur, pra në kategoritë e veçanta vihet re që bëjnë pjesë individë që për shkak të gjendjes së tyre do ta kishin shumë të vështirë të ndiqnin respektimin e të drejtave të tyre në rrugë gjyqësore, pasi bëhet fjalë për fëmijët, viktimat e dhunës në familje apo të trafikimit, të mitur, si dhe personat që përfitojnë nga skemat e mbrojtjes sociale apo që u është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar. Kjo kategori, në të shumtën e rasteve, përtej problemeve me karakter social, patjetër që vuan dhe nga pamundësi ekonomike për të paguar një avokat apo shpenzimet e tjera të domosdoshme gjyqësore, ndaj e ka të nevojshme përfitimin e ndihmës juridike nga ky ligj. Por, me ndryshimin e hartës gjyqësore dhe shkrirjen e një numri të madh të gjykatave, për këtë kategori do të vështirësohet dhe më shumë procedura e kërkesës për të përfituar nga parashikimet e ligjit të mësipërm, për të mbajtur kontaktet me avokatin që do të caktohet pas pranimit të kërkesës nga gjykata përkatëse, apo dhe për të qenë prezent fizikisht përgjatë seancave gjyqësore në momentin që e ka përfituar këtë ndihmë juridike.

Raporti i vlerësimit për propozimin e hartës së re nuk analizon varfërinë në vend (referuar papunësisë dhe të ardhurave që marrin shtetasit shqiptarë) dhe njëkohësisht as cilësinë e rrugëve dhe transportit rrugor, mjetet e munguara të transportit në disa prej zonave të thella rurale dhe aksesin e grupeve të disavantazuara ekonomikisht në përdorimin e rrugëve dhe mjeteve të transportit.[4]

Komisioni European për Efikasitetin në Drejtësi, përmes një udhëzimi me fokus krijimin e hartave gjyqësore për të mbështetur aksesin në drejtësi brenda një sistemi gjyqësor cilësor, është shprehur se: “Në shumë vende, vendndodhja gjeografike e gjykatës mund të jetë shumë e rëndësishme për shkak të nevojës për të ofruar akses në drejtësi në nivel lokal. Nevojat e transportit dhe disponueshmëria e mjeteve moderne të komunikimit ndikojnë në aftësinë e publikut për të pasur akses në drejtësi. Do të ishte e paarsyeshme të pritët që një prej palëve të udhëtojë për një periudhë të gjatë kohore. Duhet të vendoset një standard për arsyeshmërinë e kohës së kërkuar të udhëtimit.”[5]

Pra, sugjerohet që parimi që duhet zbatuar për sa i përket distancës është ai i minimizimit të saj ndërmjet gjykatës kompetente dhe të gjitha bashkive të territorit. Por, siç do të shohim, bazuar dhe në Raport Vlerësimin e KLGJ-së[6], me krijimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm koha maksimale e udhëtimit brenda juridiksionit të ri të propozuar të apelit është 4 orë e 56 minuta për qytetarët që vijnë nga Konispoli në jug. Rreth 5 orë udhëtimi i duhen tashmë banorëve të Konispolit për të ndjekur një seancë gjyqësore në Apel, parashikim kohor ky që mund të variojë, pasi në analizë nuk janë marrë një sërë faktorësh që

lidhen me aksesin në transportin publik, shpeshësinë e këtij transporti, infrastrukturën, trafikun dhe një sërë elementësh të tjerë të ndryshueshëm dhe nga faktorët atmosferikë.

Nga sa u analizua më sipër, një person që është në kushtet e përfitimit apo përfiton nga ndihma juridike dytësore dhe që jeton në zonën më jugore të Shqipërisë, duhet të udhëtojë në total, minimalisht për 10 orë gjatë ditës (duke përfshirë kthimin), për të qenë prezent fizikisht në një seancë gjyqësore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Një distancë e tillë, do të reflektohet me uljen e numrit të qytetarëve që kërkojnë respektimin dhe zbatimin e të drejtave të tyre, duke cenuar kështu dukshëm parimin e aksesit në drejtësi, pasi qytetarët do të duhet të shpenzojnë para, të humbasin një ditë të plotë pune për të qenë fizikisht në gjykatë, si dhe do t'i përfitojnë shërbimet gjyqësore për një kohë më të gjatë, krahasuar me kompetencat territoriale të gjykatave përpara miratimit të hyrjes në fuqi të hartës së re gjyqësore.

Për të konkretizuar dhe më tepër problematikën, sillet në vëmendje qëndrimi i mbajtur nga institucioni i Avokatit të Popullit[7]: “Në vlerësimin tonë zbatimi i hartës së re gjyqësore përbën një shkelje dhe kufizim të të drejtave, sepse do të shkaktojë mungesë aksesit në drejtësi edhe për viktimat e dhunës me bazë gjinore, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe viktimat nga veprat penale të ngacmimit seksual, marrëdhënive seksuale me dhunë me të rritur e të mitur. Për këtë arsye, mendohet se një riorganizim i tillë i sistemit gjyqësor, do të çojë në lëshimin e vendimeve për urdhrat e mbrojtjes pa praninë e palëve gjyqësore në proces, në rastin më të mirë vetëm me praninë e dhunuesit.”

Problematikat e përfitimit të Ndhmës Juridike Dytësore

Po të analizohen të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në raportin e analizës vjetore të performancës 2022[8], totali i vendimeve gjyqësore për kërkesat për ndihmë juridike dytësore ka qenë 1030, për periudhën janar - dhjetor 2022. Përsa i përket kategorive të personave kërkues të ndihmës juridike dytësore falas, në total evidentohet se 28% e përfituesve janë në pamundësi financiare, si mungesë të ardhurash dhe pasurie, në 61% përfshihen kategoritë e veçanta ligjore si personat viktimë të dhunës, përfitues të skemave sociale e të tjerë, ndërsa 11% e tyre janë kategori e papërcaktuar. Përsa i përket gjinisë, 65% e kërkuesve rezultojnë gra dhe 35% rezultojnë burra.

Ndërsa, totali i vendimeve gjyqësore për kërkesat për ndihmë juridike dytësore janar – qershor 2023, është 410.[9] Po të krahasohet me të njëjtën periudhë kohore, një vit më parë, pra vendimet gjyqësore janar – qershor 2022, numri total ka qenë 618, bazuar kjo në Raportin e analizës së DNJF-së.[10] Vihet re një ulje e personave përfitues të ndihmës juridike dytësore në gjysmën e parë të vitit 2023, megjithatë mbetet për tu analizuar në vijim me anë të statistikave më të plota dhe më afatgjata nëse tek këto shifra më të ulëta ka ndikuar hyrja në fuqi e hartës së re gjyqësore.

DNJF-ja, në raportin e analizës vjetore të performancës 2022, ka paraqitur dhe një nga problematikat më kryesore me të cilat përballet vetë koncepti i sistemit të ndihmës juridike. Sipas tyre për rreth 2/3 e vendimeve gjyqësore që kanë pranuar kërkesën e qytetarëve për avokatë, Dhomat Vendore të Avokatisë nuk

kanë komunikuar vendimin e caktimit të avokatit. Në këto rrethana, ndër të tjera, bëhet e pamundur vlerësimi nëse Dhomat kanë respektuar parimin e rotacionit në vendimmarrjen e tyre. Këto moskomunikime duke moszbatuar procedurat ligjore, kanë ndikuar në cilësinë e shërbimeve që kanë marrë qytetarët, por edhe në aksesin më të lehtë e më të shpejtë në drejtësi të kategorive në nevojë, që parashikon ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Çështjen e mësipërme e ka përmendur edhe institucioni i Avokatit të Popullit, në Raportin vjetor 2022[11], ku ndër të tjera, është shprehur se: Njëkohësisht, duke parë zbatimin e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili ka paraqitur vështirësi të dukshme në përfitimin e ndihmës juridike dytësore, si pasojë e moszbatimit të vendimeve gjyqësore nga ana e dhomave vendore të avokatisë, por edhe nga ulja e buxhetit për ndihmën juridike, jemi të mendimit se me një hartë të re gjyqësore këto problematika do të thellohen, duke mohuar drejtësinë për këto kategori.

Në mënyrë të përmbledhur, problematikat më kryesore mbi ofrimin e ndihmës juridike dytësore kanë qenë këto:

- Disa vendime të gjykatave vijnë pa firmë dhe vulë sipas parashikimeve në Kodi i Procedurës Civile, përmendim këtu Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës dhe rretheve vijnë deri më 6 muaj vonesë në protokollin e DNJF-së, duke sjellë pasoja për qytetarët;
- Është vënë re se avokatët kalojnë afatin 3 muajor për ngritjen e padisë në gjykatat e juridiksionit;

- Mungesa e informacionit nga momenti i ngritjes së padisë deri në çdo fazë të gjykimit, civil, penal, administrativ nga avokatët dhe dhomat e avokatisë në Tiranë dhe rrethe;
- Dhomat Vendore të Avokatisë nuk përcjellin vendimet për caktim avokati pranë DNJF-së.

Vlerësohet se dhe këto problematika me të cilat është hasur DNJF-ja përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj duhet të ishin marrë në analizë nga grupi i punës apo nga vetë KLGJ-ja në vlerësimet që ky institucion bëri për të vendosur ndryshimin e hartës ekzistuese gjyqësore dhe uljen e numrit të gjykatave, pasi padyshim që ristrukturimi i kompetencave territoriale ka sjellë ndryshime dhe në ngarkesën e gjykatave, në distancat e tyre me qytetarët dhe avokatët që ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike dytësore. Një mosanalizim i tyre mund të sjellë thellimin e mëtejshëm të problematikave tashmë të evidentuara. Së bashku me të, ka qenë i nevojshëm konsultimi me qytetarët në të gjitha bashkitë e vendit, për të kuptuar problematikat me të cilat ata mund të hasen me miratimin e hartës së re gjyqësore.

Nga ana tjetër, perceptimi qytetar dhe besimi i publikut tek sistemi gjyqësor përbën një prej faktorëve më thelbësorë, mbi të cilin e bazojnë punën e tyre të përditshme vetë institucionet e reja të drejtësisë, ndaj ato duhet të merreshin në analizë së bashku me të dhëna objektive, faktike apo të karakterit administrativ e operativ. Është e nevojshme të kuptohet se si ka ndikuar distanca e krijuar prej ristrukturimit të gjykatave tek perceptimi i njerëzve për aksesueshmërinë e sistemit të drejtësisë.

Harta e re gjyqësore është tashmë një fakt, ndaj dhe në vijim duhet analizuar me detaje ecuria e kësaj reforme të re që ka prekur të gjithë sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Do të nevojitet një kohë më e gjatë që efektet e saj, qofshin këto pozitive apo negative, të jenë të dukshme. Për të parandaluar, pasoja të mundshme negative, mund të merren disa masa me karakter paraprak dhe pasi efektet të jenë më të dukshme, duhet të merren masa apo të gjenden zgjidhje të një karakteri më të qëndrueshëm. Duke u bazuar në analizën e thelluar që u përpoq të sillte ky artikull mbi ndryshimet në hartën gjyqësore, si dhe me pasqyrimin e gjendjes së ndihmës juridike dytësore, disa rekomandime për të shmangur cenimin e aksesit në drejtësi do të ishin:

- Zgjerimi i fashës së kategorive që përfitojnë nga ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, apo ndryshimi i nivelit të të ardhurave që duhet të fitojë një person për të qenë përfitues i ndihmës juridike dytësore, pasi duhet të merren në konsideratë kostot e rritura si pasojë e distancës së gjykatave nga vendbanimi i qytetarëve;
- Të kërkohet zbatimi më i mirë i ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, sidomos për aspektet procedurale. Dhomat Vendore të Avokatisë duhet të komunikojnë vendimet e caktimit të avoktit në kohë dhe në respektim të të gjitha procedurave të parashikuara;

- Të vendosen afate të prera ligjore mbi pagesat e avokatëve të përfshirë në proceset e ofrimit të ndihmës juridike dytësore, pasi praktika ka shfaqur problematika, duke sjellë kështu uljen e numrit të avokatëve që lidhin kontratë të përvitshme me DNJF-në për të ofruar shërbimet e tyre;
- Rritja e buxhetit për shërbimin e ndihmës juridike;
- Parashikime konkrete lidhur me mundësinë e palëve për të marrë pjesë në seancat gjyqësore dhe në mënyrë virtuale, duke krijuar një sistem të mirëfilltë në të gjitha gjykatat, pasi kështu shmangen problemet e distancës nga vendbanimi në gjykatë, si dhe nuk cenohet parimi bazë i aksesit në drejtësi;
- Mundësi për të subvencionuar shpenzimet e transportit për ndjekjen e seancave gjyqësore nga palët, si dhe përmirësimet e infrastrukturës dhe sistemit të transportit publik;
- Në caktimet e orareve të seancave gjyqësore me praninë e palëve, duhet të merret në konsideratë nga gjyqtarët distanca e palëve nga vendndodhja e gjykatës, në mënyrë që të mos ketë shtyrje dhe zgjatje të panevojshme të procesit gjyqësor. Mund të caktohen orare pak më të vona për palët që vijnë nga zona të largëta, krahasuar me palët që u nevojitet kohë më e shkurtër për tu paraqitur në gjykatë.

[1] Raport Vlerësimi nga KLGJ “Një hartë e re gjyqësore për Shqipërinë” <https://klgj.al/Wp-content/uploads/2022/06/KLGJ-Raport-Vleresimi-NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-maj-2022.pdf>

[2] Shih për më shumë nenin 11 të ligjit nr. 111//2017 “Përndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

[3] <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/03/01/113>

[4] Komiteti Shqiptar i Helsinikt, dokument qëndrimesh “Dritëhijet dhe efektet e hartës së re gjyqësore”.

[5] Shih për më shumë: https://rm.coe.int/european-commission-for-the-efficiency-of-justice-cepej-revised-guidel/168078c492#_Toc356475577

[6] Raport Vlerësimi nga KLGJ “Një hartë e re gjyqësore për Shqipërinë” <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/06/KLGJ-Raport-Vleresimi-NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-maj-2022.pdf>

[7] Raporti vjetor “Për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit”, viti 2022.

[8] <https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/analiza-performances-DNJF-2022-2.pdf>

[9] <https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/6.-Analiza-Statistikore-Qershor-2023.pdf>

[10] <https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Analiza-Statistikore-Ndihma-juridike-paresore-dhe-dytesore-si-dhe-te-dhena-per-shpenzimet-gjyqesore-Qershor-2022.pdf>

[11] Raporti vjetor “Për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit”, viti 2022.